



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

SHËRBIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

RAPORT VJETOR 2013

Tiranë, Maj 2014

PASQYRA E LËNDËS

Fjala hyrëse e Ministrit të Punëve të Brendshme	3
Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së	4
Falënderime	6
Hyrja e Raportit Vjetor 2013.....	7
Veprimtaria e strukturave hetimore	9
Veprimtaria e strukturave inspektuese.....	15
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Financës.....	27
Trajnimi i personelit hetues dhe inspektues.....	28
Bashkëpunimi me Drejtorinë e Standardeve Profesionale në PSH.....	30
Objektiva për SHKB-në.....	31
Si mund të na kontaktoni.....	32

Fjala e Ministrit të Punëve të Brendshme, Z. Saimir TAHIRI



Të nderuar qytetarë!

Kam kënaqësinë t'ju paraqes Raportin Vjetor të Punës për Vitin 2013, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në këtë dokument pasqyrohen arritjet, mangësitë dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e standardeve të shërbimit.

Synimi ynë në paraqitjen e këtij raporti është të evidentojmë para opinionit publik treguesit e punës, të lidhur ngushtë me ata të Policisë së Shtetit dhe njëherësh, të projektojmë masat që do të marrim, për të rritur efektivitetin e shërbimit dhe forcuar integritetin e Policisë së Shtetit.

Në analizën e punës së bërë, nuk mund të shmangim gjendjen në të cilën e gjetëm shërbimin, kur morëm detyrën, ku një pjesë e konsiderueshme e personelit ishin nga radhët e militantëve, të marrë në kundërshtim me kriteret ligjore dhe me nivel të ulët profesional.

Treguesit e dobët në parandalimin e shkeljeve ligjore dhe korrupsionit në radhët e Policisë, flisnin për keqpërdorim të këtij shërbimi nga institucionet drejtuese, si dhe për përvojën e reformimit e vënies në pozita pune të tij.

Ndërmarrja e masave të shpejta, duke freskuar personelin e shërbimit dhe ndryshuar menaxhimin e brendshëm, shume shpejt dhanë rezultatet e para. Vetëm në tremujorin e fundit të vitit që shkoi, ky shërbim rriti tre herë më shumë, efektivitetin e punës në luftën kundër korrupsionit e abuzimeve të ndryshme në radhët e Policisë së Shtetit, në raport me muajt e mëparshëm.

Ligji i ri për këtë shërbim, synon ta shndërrojë atë, në një institucion modern të standardeve europiane, me nivel të lartë profesional, aktiv ndaj çdo ankese të opinionit publik për shërbimin policor, transparent me punonjësit e Policisë së Shtetit dhe komunitetin. Shërbimi në të ardhmen do të ndryshojë cilësisht në përbërjen e vetë, në veprimtarinë për trajtimin e ankesave e denoncimeve të qytetarëve si dhe në kontributin për forcimin e vlerave e integritetit të Policisë së Shtetit.

Ligji i ri do ta shndërrojë këtë shërbim në një Agjenci të Mbikqyrjes së Jashtme Qytetare, me personel civil, që do të trajtojë në mënyrë institucionale ankesat e publikut, duke kombinuar veprimtarinë “reaguese” në luftën kundër korrupsionit, me atë “proaktive”, për të zgjidhur fenomenet e korrupsionit dhe sjelljeve joetike të policisë.

Shërbimi si një institucion i pavarur do të garantojë për qytetarët një shërbim policor të bazuar në parimet e policimit demokratik; zbatimin e ligjshmërisë dhe etikës policore, garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit; llogaridhënien dhe transparencën me opinionin publik.

Ndryshimet organizative, të realizuara gjatë kësaj periudhe, treguesit e arritur në evidentimin e rasteve korruptive, si dhe mbështetja me një teknikë e trajtim më të mirë të punonjësve, kanë krijuar kushtet e duhura për të ndryshuar në standardet dhe efektivitetin e këtij shërbimi.

Ju ftoj, të bashkëpunoni me Shërbimin edhe në të ardhmen, për të denoncuar çdo shkelje e abuzim në shërbimin policor, si dhe mbështetur atë për forcimin e integritetit e standardeve në fushën e sigurisë.

FJALA HYRËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM z. Arben SKËNDO



Të nderuar qytetarë!

Prezantimi para jush i Raportit Vjetor të Punës së SHKB-së për vitin 2013, është një detyrim ligjor. Ai përmbush parimin e llogaridhënies si çelësi i kontrollit demokratik ndaj institucioneve. Ne ndajmë me ju jo vetëm arritjet dhe rezultatet por edhe mangësitë me problematikat e hasura gjatë këtij viti, si në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë së shërbimit ashtu edhe në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe vetkontrollit të brendshëm.

Unë dhe stafi që drejtoj, jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që ka ky shërbim në radhë të parë ndaj publikut dhe së dyti ndaj vetë strukturave që ai mbikqyr, kontrollon dhe këshillon.

Shërbimi duhet t'i shërbejë publikut, të jetë transparent, komunikues dhe të ketë një bashkëveprim të drejtpërdrejtë me qytetarët, për të evidentuar çdo rast të shkelje të kryera nga punonjës policie, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Por njëkohësisht, ky shërbim, duhet të ushtrojë ndikimin e tij të vazhdueshëm në fushën e llogaridhënies policore, integritetit policor, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, si dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë të kontrollit të jashtëm qytetar ndaj Policisë së Shtetit por edhe ndaj vetë shërbimit.

Me mbështetjen e Ministrit të Punëve të Brendshme Z. Saimir Tahiri, së bashku me gjithë personelin e shërbimit, kemi ndërmarrë veprime organizative dhe programuar objektivat dhe synimet tona afatmesme dhe afatgjata për forcimin e kapaciteteve të shërbimit dhe arritjen e standardeve më të larta në fushën e të zbatimit të ligjit të mbikqyrjes policore dhe anti-korrupsionit.

Objektivat dhe synimet tona së pari afatshkurtra për periudhën Shtator - Dhjetor 2013, u fokusuan në rivendosjen e ligjshmërisë dhe daljen nga "apatia" e strukturave të shërbimit. Disiplinimi i shërbimit u arrit nëpërmjet rishikimit të procedurave të ndjekura gjatë procesit të rekrutimit, emërimit, ecurisë në karrierë e gradë të punonjësve të personelit hetues e inspektues të shërbimit, mbështetur në ligjshmërinë dhe zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

Vënja në efikasitet e strukturave të shërbimit u bë e mundur nëpërmjet hartimit të një plani-afatshkurtër të veprimit si në fushën e hetimit ashtu edhe të inspektimit me qëllim rifillimin normal të procesit të punës i cili ishte i ndërprerë në pjesën më të madhe të sektorëve e veçanërisht në atë të procesit hetimor dhe operacional.

I gjithë ky proces masash dhe aktiviteteve që u ndërmorën i dhanë rezultatet konkrete në rritjen e nivelit të zbulueshmërisë së rasteve të shkeljeve, dokumentimit ligjor dhe hetimit paraprak të veprimtarisë së kundraligjshme të kryer nga punonjës të veçantë policie dhe siç do të gjeni në raport, statistikat ilustrojnë më së mirë vënien në efikasitet dhe rritjen e treguesve të punës në çdo sektor.

Në zbatim të objektivave strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të përcaktuara në strategjinë institucionale 2014 – 2020, edhe në shërbim hartuam objektivat strategjike, me synim reformimin ligjor, organizativ dhe funksional të shërbimit.

Duke u nisur nga gjendja juridike dhe perceptimet mbi shërbimin, pas një pune disa mujore të ekspertëve të asistuar nga partnerët ndërkombëtare ne kemi paraqitur në Parlamentin e Shqipërisë projekt-ligjin e ri për “Shërbimin për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme” në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ky reformim i ka bazat tek parimet e agjencive të mbikqyrjes policore në vendet me të zhvilluara demokratike të Amerikës së Veriut, Britanisë dhe Australisë. Parimet që e përshkojnë këtë projekt-ligj janë: policia kontrollohet nga civilët, realizimi i mbikqyrjes së jashtme qytetare, transparencja, komunikimi dhe bashkëveprimi i drejtpërdrejtë i strukturave me qytetarët, vendosja e ankesave në qendër të veprimtarisë së shërbimit, analiza e informacionit kriminal, përqasja proaktive e veprimtarisë inspektuese dhe hetimore, përgjegjshmëria dhe llogaridhënia policore.

Dua të theksojë dhe vlerësojë ndihmën e dhënë nga partnerët tanë, në veçanti të programit të Departamentit të Drejtësisë ICITAP dhe PAMECA-IV si në fushën e këshillimit dhe asistencës ligjore në draftimin e projekt-ligjit të ri për shërbimin, në trajnimin e vazhdueshëm të personelit si dhe ndihmat me pajisje.

Përshëndesim bashkëpunimin me organin e Prokurorisë, në veçanti me atë për Krimet e Rënda, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si dhe institucionet e tjera ligjzbatuese që kanë ndarë me ne këtë periudhë, problemet dhe aktivitetet në përmbushjen e detyrimeve të përbashkëta institucionale.

Ne do të jemi të përkushtuar për forcimin e kapaciteteve të brendshme të shërbimit, rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të performancës së gjithsecilit prej nesh në ushtrimin e detyrës funksionale, me synimin për të garantuar respektimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut nga policia; rritjen e besimit të publikut tek policia.

Si përfundim: duke qenë të vetëdijshëm se kontrolli i brendshëm është i rëndësishëm në luftën ndaj korrupsionit, se ky kontroll i mbështetur nga mbikqyrja e jashtme qytetare përmirëson menaxhimin dhe imazhin e policisë, ndihmon në respektimin e etikës së punonjësit të policisë, kontribuon në bërjen e një organizate policie sa më të përgjegjshme, ne ftojmë qytetarët dhe institucionet, të mbështesin punën tonë e cila ju sigurojmë do të jetë më e vlefshme se deri tani.

Pë këtë arsye ne po punojmë për të garantuar një marrëdhënie të re ndërmjet kontrollit të brendshëm dhe atij të jashtëm qytetar, një model me të gjithë komponentet mbi informimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me publikun.

Ju faleminderit.

FALENDERIME!

Falënderojmë qytetarët që kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar SHKB-në në përmbushjen e misionit të saj ligjor.

Falënderojmë Ministrin e Punëve të Brendshme, Z.Saimir Tahiri për mbështetjen që na ka dhënë për të kapërcyer problematikat e evidentuara dhe rivënien në efikasitet të kapaciteteve të brendshme të shërbimit.

Falënderojmë partnerët tanë ndërkombëtarë: ICITAP, PAMECA dhe OSBE, të cilët kanë asistuar nga afër punën tonë duke na këshilluar me praktikën më të mirë Euro-Atlantike, si dhe kanë bërë të mundur zhvillimin e një cikli trajnimesh për personelin hetues dhe inspektues të SHKB-së. Në mënyrë të veçantë Z. Frank Harris, këshilltar i programit ICITAP, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili ka asistuar dhe këshilluar shërbimin në reformimin ligjor, strukturor dhe funksional të tij.

Falënderojmë, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe prokuroritë në rrethe, për bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në përmbushjen e detyrimeve tona ligjore.

Falënderojmë stafin drejtues të Policisë së Shtetit për mirëkuptimin për të bashkëpunuar në fushën e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë policore.

Falënderojmë të gjitha agjencitë e tjera ligjzbatuese për bashkëpunimin që na ka ofruar në luftën kundër korrupsionit dhe forcimit të ligjshmërisë.

Falënderojmë, organizatat joqeveritare me fokus përgjegjshmërinë dhe etikën policore, e në veçanti IDM, për vullnetin dhe gadishmërinë për të bashkëpunuar dhe bashkëvepruar me ne.

Punonjësit e shërbimit, që me përkushtim dhe profesionalizëm punojnë për përmbushjen e objektivave të organizatës sonë.

Falënderojmë grupin e punës të cilët hartuan këtë dokument si një instrument i rëndësishëm në funksion të transparencës së shërbimit me publikun.

HYRJA E RAPORTIT VJETOR 2013

Analiza e punës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në MPB, për vitin 2013, përkon me një etapë të rëndësishme, ku të gjitha agjencitë ligjzbatuese, të orientuara nga programi i integruar anti-korrupsion i Qeverisë Shqiptare, janë të angazhuara në përmbushjen e rekordeve më të larta, si në luftën ndaj korrupsionit, ashtu edhe në luftën ndaj krimit të organizuar dhe rivendosjes së ligjshmërisë e standardeve të BE-së në gjithë institucionet e vendit.

Stafi i ri drejtues i këtij shërbimi, i cili filloi punë në këtë detyrë, në mes të muajit Shtator 2013, fillimisht analizoi punën e deriatëhershme, për të parë nivelin e realizimit të misionit ligjor dhe objektit të veprimtarisë së SHKB-së, në funksion të evidentimit të problematikave, me qëllim orientimin në përputhje me misionin, si dhe përmirësimin e standardeve dhe performancës së shërbimit.

Pikërisht, për këto arsye, veprimtaria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm gjatë vitit 2013, përbëhet prej dy tablove: ajo e periudhës Janar-Shtator, e karakterizuar me një sërë mangësish dhe problematikash në aspektin menaxherial, organizativ, strukturor dhe funksional, si dhe periudha Tetor-Dhjetor, e karakterizuar nga përpjekje serioze për eliminimin e problematikave penguese të cilat kishin sjellë një performancë dhe nivel tepër të ulët të rezultateve të shërbimit.

Qëndrimi kritik ndaj periudhës Janar-Shtator, nuk ka të bëjë me asnjë paragjykim apo një mohim të padrejtë të atyre arritjeve të cilat do të ishte gabim t'i mohonte çdokush. Por stafi i ri, për gjëndjen konkludoi edhe mbi bazën e një monitorimi korrekt nga partnerët dhe kryesisht ICITAP, të cilët në raportet e tyre ishin shprehur qartë se: “shërbimi ka qenë pa potencialin e plotë të funksionimit të tij dhe pa të njëjtin sukses si agjencitë e mbikëqyrjes policore si në vendet e tjera...” dhe gjatë vitit 2012, ka patur vetëm 1.4 çështje penale për çdo specialist, gjë e cila nuk ndryshoi por vazhdoi deri në muajin Shtator të vitit 2013.

Drejtuesit e MPB dhe në veçanti Ministri i Punëve të Brendshme, që në fillim të punës kanë parashtruar detyrime konkrete në kuadër të goditjes dhe penalizimit të çdo punonjësi policie të lidhur me krimin dhe i vënë në shërbim të tij. Shërbimit i janë dhënë mesazhe të qarta mbështetje të cilat në kohë të shkurtër kanë frenuar rënien dhe rivendosjen brenda misionit të të gjithë veprimtarisë administrative dhe procedurale të tij. Jemi ndihmuar duke u mbështetur edhe në trajtimin më të mirë buxhetor e financiar për punonjësit e shërbimit.


Në këtë kuadër është përqendruar puna në dy drejtime, në vënien në efikasitet të kapaciteteve të brendshme dhe në reformimin strukturor e ligjor të shërbimit.

Trajtimi i dy çështjeve të mësipërme u pa si nevojë emergjente për parandalimin e korrupsionit në radhët e Policisë së Shtetit.

Në kuadër të riorganizimit të strukturës dhe përcaktimit të prioriteteve i është kushtuar kujdes planizimit shkencor të punës dhe përqëndrimit të diferencuar të burimeve njerëzore duke vendosur në vendin e punës specialistin e aftë e të duhur.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHKB-SË

Struktura e SH.K.B-së



Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, është një strukturë e veçantë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në varësi të Ministrit të Brendshëm. Është i organizuar në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme, me numër të personelit **104** punonjës të ndarë:

- **85** funksione janë personel hetues
- **9** funksione janë personel inspektues
- **10** funksione janë personel për shërbimet mbështetëse.

Shpërndarja e personelit të shërbimit në bazë të funksioneve të miratuara është bërë në nivel qendror në Departamentin e Hetimit me **38** funksione dhe nivel vendor me **47** funksione, në nivel qendror Drejtoria e Inspektimeve me **9** funksione dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me **10** funksione.

VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE HETIMORE TË SHKB-SË

Për një veprimtari hetimore të sukseshme ne jemi udhëhequr nga parimet bazë të procedimit penal, duke identifikuar në bazë të ankesave dhe kontrollit të brendshëm veprat penale të kryera si dhe shkeljet e ligjit nga punonjësit e policisë. Në zbatim të planit afatshkurtër Shtator - Dhjetor 2013 janë përcaktuar si detyra prioritare: zhvillimi i një strategjie të hetimit të ndërthurur me inspektimin, përdorimi në proces renditës i teknikave të hetimit, menaxhimi i procesit të hetimit në bashkëpunim me prokurorinë. Shërbimi ka qenë i gatshëm dhe është përballur me çdo lloj shkelje ligjshmërie apo veprë penale të shfaqur në radhët e policisë dhe kjo është një tipar domëthenës për ne.

Gjatë vitit 2013, strukturat e hetimit të SHKB-së në nivel vendor e qëndror, në përmbushje të objektit të veprimtarisë së shërbimit atë të *“parandalimit, zbulimit, dokumentimit dhe hetimit paraprak të veprimtarisë së kundraligjshme që kryhet nga punonjës policie pavarësisht funksionit dhe gradës”*, mbi bazën e hetimit “reaktiv” dhe “proaktiv”, ka referuar pranë organit të Prokurorisë materialet kallëzuese si vijon:

- 134 kallëzime penale për
- 170 punonjës policie ku:
- 1 punonjës policie i nivelit të lartë drejtues
- 4 punonjës policie të nivelit të mesëm drejtues
- 63 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 88 punonjës policie të nivelit zbatues
- 14 punonjës policie të strukturave civile dhe
- 8 shtetas

Nga këta janë ndaluar/arrestuar në flagrancë 27 persona nga të cilët 23 punonjës policie dhe 4 shtetas, ndërsa të tjerët janë në hetim në gjendje të lirë.

Tabela e kallëzimeve penale sipas veprave penale dhe niveleve të punonjësve të policisë


Viti	Lloji i veprës penale	Nr. çështjeve penale	Nr. subjekteve	Nivelet						Arrestuar	
				I lartë	Mesëm drejtues	Parë drejtues	Zbatues	Punonjës civile	shtetas	Punonjës policie	shtetas
2013	Vepra korruptive	87	117	1	3	44	59	10	4	20	4
	Veprime arbitrare	13	21	-	1	6	14	-	-	-	-
	Vepra te tjera	34	32	-	-	13	15	4	4	3	-
	Totali	134	170	1	4	63	88	14	8	23	4

Tabela e kallëzimeve penale sipas 3- katërmujorve të vitit 2013

Periodha	Nr. çështjeve penale	Nr. subjekteve	Nivelet						Arrestuar	
			I lartë	Mesëm drejtues	Parë drejtues	Zbatues	Punonjës civile	shtetas	Punonjës policie	shtetas
Janar - Prill	47	49	-	1	14	31	3	4	11	4
Maj - Gusht	37	48	-	-	20	27	1	-	-	-
Shtator - Dhjetor	50	73	1	3	29	30	10	4	13	-
Viti 2013	134	170	1	4	63	88	14	8	23	4

Siç rezulton dhe nga të dhënat statistikore kemi një rritje të nivelit të zbulueshmërisë të numrit të veprave penale dhe të punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje të ligjit. Gjithashtu evidentimi i rasteve të shkeljeve jo vetëm të punonjësve të policisë së nivele zbatues, por në rritje në ato të nivele të larta drejtuese.

Paraqitje grafike sipas grup-veprave penale të ndara në 3-katërmujor të vitit 2013



Shënim: vepra korruptive përbledhin grupin e veprave penale të përcaktuara në Kodin Penal si vijon: “korrupsion pasiv”, “shpërdorim detyre”, “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, “fallsifikim” etj..

Paraqitja grafike e hetimeve të kryera ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë vitit 2013




Tabela përmblledhëse e hetimeve për vitin 2013 nga strukturat e SHKB-së

Nr.	Drejtoria/Sektorë të SHKB-së në qarqe	Nr. Kallëzimeve penale	Nr. Punonjësve të policisë	Sipas nivelit të gradave				
				I lartë	Mesëm drejtues	Parë drejtues	Zbatues	Punonjës civile
1.	TIRANA	40	44	-	-	18	24	2
2.	SHKODRA	4	4	-	-	1	2	1
3.	KUKËSI	4	5	-	-	1	4	-
4.	LEZHA	4	4	-	-	-	4	-
5.	DIBRA	9	13	-	1	5	6	1
6.	ELBASANI	6	5	-	-	3	2	-
7.	DURRËSI	10	20	-	-	7	13	-
8.	KORCA	20	21	-	1	8	11	1
9.	FIERI	11	15	-	-	5	9	1
10.	BERATI	2	2	-	-	2	-	-
11.	VLORA	1	1	-	-	1	-	-
12.	GJIROKASTRA	9	10	-	-	3	7	-
13.	DREJTORIA E HETIMIT	14	26	1	2	9	6	8
14.	TOTALI	134	170	1	4	63	88	14

Hetime të suksesshme gjatë vitit 2013

Gjatë vitit 2013, nga strukturat e hetimit të shërbimit në nivel qendror e vendor, mbi bazën e veprimtarisë administrative, informativo-gjurmuese, hetimit administrative dhe përdorimit të teknikave dhe metodave speciale të hetimit e përqasjes proaktive nga oficerët e policisë gjyqësore të SHKB-së, janë kryer disa hetime të suksesshme për goditjen e veprimtarisë kriminale të kryer nga punonjës policie. Në mbi 90% të rasteve të referuara në prokurori nga oficerët e policisë gjyqësore të SHKB-së, prokurori që drejton hetimin ka autorizuar ndjekjen e veprimeve hetimore procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të SHKB-së. Rastet e hetimeve më të suksesshme i paraqesim si më poshtë vijon:

1. Proçedimi penal **nr. 1827, viti 2013**, në ngarkim të **1 punonjësi policie**, me gradën **Drejtnes**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, për veprën penale “Korrupsion pasiv” dhe “Kontrabandë me mallra të tjerë”, parashikuar nga nenet 259 e 174 të Kodit Penal. Pas një pune hetimore 1-mujore, përdorimit të metodave dhe teknikave speciale të hetimit, me vendim gjykate u krye arrestimi në flagrancë, hetohet në gjendje të lirë. Aktualisht, çështja është në hetim me detyra të deleguara nga prokurori i çështjes, për strukturat përkatëse të shërbimit. Masa disiplinore “Përrjashtim nga Policia e Shtetit”

2. Proçedimi penal **nr. 946, viti 2013**, në ngarkim të **2 punonjësve të policisë, 1 punonjës policie** me gradën **N/Komisar**, me detyrë përgjegjës turni në Qëndrën e Shkëmbimit të Informacionit, Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit dhe **1 punonjës policie** me gradën **Asistent i Parë**, me detyrë trup shërbimi, operator sistemi në Pikën e Kalimit Kufitar, për veprën penale të “korrupsionit pasiv”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Pas një pune hetimore 1-mujore, përdorimit të metodave dhe teknikave speciale të hetimit, me vendim gjykate u krye arrestimi në flagrancë i punonjësve të policisë. Çështja u kalua në gjykim dhe punonjësit u deklaruan fajtor duke u dënuar respektivisht me:

- *18 muaj heqje lirie, në aplikim të neneve të Kodit të Procedurës Penale pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe kalimin në shërbim prove për një periudhë 2 vjet;*
- *9 muaj heqje lirie, në aplikim të neneve të Kodit të Procedurës Penale, ulje të dënimit në 6 muaj heqje lirie;*
- *masa disiplinore e “Përrjashtim nga Policia e Shtetit”.*

3. Proçedimi penal **nr. 74, viti 2013**, në ngarkim **2 punonjësve të policisë**, me gradën **Inspektor** dhe me detyrë trup shërbimi pranë seksionit të qarkullimit rrugor në Komisaratin e Menaxhimit dhe Transferimit Interurban, për veprën penale të “korrupsionit pasiv”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Hetim proaktiv, inicuar me informacion, përdorimi i formave dhe metodave speciale të hetimit, përgjimi ambjental dhe simulimi etj, çuan në arrestimin në flagrancë të punonjësve të policisë. Çështja u kalua në gjykim, ku 2 punonjësit e policisë u deklaruan fajtor dhe u dënuan respektivisht:

- *3 vjet e 3 muaj burg, në aplikim të neneve të Kodit të Procedurës Penale pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe kalimin në shërbim prove për një periudhë 3 vjecare.*
- *2 vjet e 2 muaj burg, në aplikim të neneve të Kodit të Procedurës Penale pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe kalimin në shërbim prove për një periudhë 3 vjecare.*
- *masa disiplinore e “Përrjashtim nga Policia e Shtetit”*

4. Proçedimi penal **nr. 296, viti 2013**, në ngarkim të **1** punonjësi policie me gradën **Inspektor**, me detyrë trup shërbimi pranë Komisarariatit të Policisë, për veprën penale të “vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Pas përdorimit të teknikave speciale të hetimit, me vendim gjykate u bë e mundur arrestimi në flagrancë i punonjësit të policisë. Çështja u kalua në gjykim dhe punonjësi i policisë u deklarua fajtor dhe u dënua:

- *18 muaj burg, në aplikim të neneve të Kodit të Proçedurës Penale dënimin përfundimisht me 12 muaj burg.*
- *masa disiplinore e “Përrjashtim nga Policia e Shtetit”.*

5. Proçedimi penal **nr. 4916, viti 2013**, në ngarkim të **5** punonjësve të policisë ku **1** punonjës policie me gradën **Komisar**, me detyrë shefi i komisionit të kundravajtjeve administrative, **2** punonjës policie me gradën **N/Komisar**, me detyrë anëtar i seksionit të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, **1** punonjës policie me gradën **Komisar**, me detyrë shefi i seksionit të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative për qarkullimin rrugor dhe **1** punonjës policie me gradën **Inspektor**, me detyrë ndihmës specialist në seksionin e shqyrtimit e administrimit të dokumentave pranë komisionit të kundravajtjeve, në Komisariatin e Policisë Rrugore, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, “korrupsionit pasiv” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 259 e 25 të Kodit Penal. Hetim proaktive, inicuar mbi bazën e informacionit të grumbulluar gjatë inspektimit të strukturave të sipërpërmendura nga Drejtoria e Inspektiveve të SHKB-së. Çështja është në hetim dhe ndiqet me detyra të deleguara nga prokurori i çështjes, prej sektorit përkatës së strukturave hetimore të shërbimit.

6. Proçedimi penal **nr. 7355, viti 2013**, në ngarkim të **8** punonjësve të strukturave civile të Policisë së Shtetit dhe **2** drejtues të nivelit të lartë, për veprat penale të “shpërdorim detyre” dhe “shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 25, 248 dhe 258 të Kodit Penal. Hetim proaktiv, inicuar mbi bazën e informacionit të grumbulluar nga strukturat e inspektimit të shërbimit, për parregullsitë e evidentuara në proçedurat e prokurimit me objekt “spote publicitare”. Çështja është në hetim me detyra të deleguara nga prokurori i çështjes, prej sektorit përkatës të strukturave hetimore të shërbimit.

7. Proçedimi penal **nr. 699, viti 2013**, në ngarkim të **1** punonjësi policie me gradën **N/Komisar**, me detyrë shef i seksionit kundër trafikeve të paligjshme, për veprën penale të “korrupsionit pasiv dhe aktiv nga persona që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga nenet 259 e 244 të Kodit Penal. Pas përdorimit të teknikave speciale të hetimit u bë e mundur arrestimi në flagrancë me vendim gjykate i punonjësit të policisë. Aktualisht gjykata ka vendosur masën e sigurisë “arrest shtëpie”, dhe çështja është dërguar në gjykim. Masa disiplinore “Përrjashtim nga Policia”.


8. Proçedimi penal **nr. 159/1, viti 2013**, në ngarkim të **1** punonjësi policie me gradën **N/Komisar**, me detyrë specialist i parandalimit dhe hetimit të krimit në Komisariatin e Policisë, për veprat penale të “shpërdorimit të detyrës” dhe “korrupsionit pasiv”, parashikuar nga nenet 248 e 259 të Kodit Penal. Me vendim gjykate është bërë arrestimi në flagrancë i këtij punonjësi, aktualisht me masë sigurie “arrest shtëpie”. Kanë përfunduar hetimit dhe pritet që çështja të kalojë në gjykim. Masa disiplinore “Përrjashtim nga Policia e Shtetit”.

8. Proçedimi penal **nr. 5221, viti 2013**, në ngarkim të **1** punonjësi policie me gradën **Inspektor**, me detyrë efektiv i strukturave të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore, për veprën penale të “fallsifikimit të dokumentave” dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 186/3 dhe 248 i

Kodit Penal. Pas në punë hetimore disa mujore dhe përdorimit të metodave dhe teknikave speciale të hetimit me vendim gjykate u bë arrestimi në flagrancë i këtij punonjësi policie. Gjykata ka vendosur masën e sigurisë “arrest në burg”. Aktualisht çështja është gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Masa disiplinore “Përfundim nga Policia e Shtetit”.

Tabela me të dhëna për referimet e veprave penale sipas viteve

Nr. Referimeve për veprave penale sipas viteve	2009	2010	2011	2012	2013	Mesatarja për 5 vite	Rritje/rënie në % krahasuar me vitin 2009
Vepra korruptive	56	57	63	64	87	65.4	15.2% rritje
Veprime arbitrare	35	11	21	28	13	21.6	47.8 % rënie
Vepra te tjera	22	13	17	13	34	19.8	34.7 % rritje



VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE INSPEKTUESE TË SHKB-së

Struktura e inspektimit është një strukturë e re e krijuar si një risi në ligjin e SHKB-së në modelet më të avancuara të vendeve të EPAC. Kjo strukturë ka marrë gjithë mbështetjen dhe përkujdesjen e partnerëve në kualifikim e trajnim për të aftësuar dhe përgatitur specialistët kryesisht në hetimet proaktive. Në performancën e saj për vitin 2013 vlerësohet me kontribute modeste e jo në nivelin e pritshëm. Me mbështetjen e dhënë së fundmi për forcimin e strukturës së saj, duke e lidhur hetimin administrativ me atë të shqyrtimit të ankesave dhe pas disa trajnimeve të punonjësve vërehet se inspektimet janë jo më sipërfaqësore dhe rekomandimet e tyre gjithnjë dhe me cilësore e produktive.

Gjatë viti 2013, nga strukturat e inspektimit të shërbimit, mbi bazën e planit vjetor të miratuar kanë kryer **14** inspektime të zakonshme si dhe **9** inspektime të jashtëzakonshme **8** nga të cilat në periudhën Shtator-Dhjetor 2013.


Veprimtaria inspektuese nuk është shumë e matshme nga ana sasiore, ajo vlerësohet nga ana cilësore, nga mënyra se sa dhe si arrin të evidentojë problemet, problematikat në të gjitha aspektet e zbatimit të ligjit dhe të performancës së veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit.

Inspektimi zë një fushë të gjërë të kontrollit të strukturave policore që nga ajo e infranstrukturës ligjore, menaxhimit strukturor, funksional, organizativ, të burimeve njerëzore dhe logjistike e deri tek lidhshipit, etika, sjellja individuale dhe kolektive e policisë.

Në inspektimet e kryera vlerësojmë si arritje pozitive se;

- Produkti i inspektimit është përdorur si indicje për fillimin e një hetimi penal ndaj punonjës/it/ve të policisë së strukturave të inspektuara, konkretisht në **8** inspektime janë penalizuar **23** punonjës policie;
- Produkti i inspektimit është përdorur si bazë për fillimin e ecurisë disiplinore nga strukturat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konkretisht **8** raste për **50** punonjës policie;

Grafiku i Inspektimeve për vitin 2013



INSPEKTIMET E ZAKONSHME

1. “Vlerësimi i kryerjes së Detyrave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Tiranë”.
2. “Vlerësimi i kryerjes së Detyrave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës”.
3. “Vlerësimi i kryerjes së Detyrave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan”.
4. “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë”.
5. “Vlerësimi i kryerjes së Detyrave të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë”.

Qëllimi i inspektimit: “Të evidentojë, analizojë dhe vlerësojë me objektivitet performancën e Drejtorive të Policive në Qarqet, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Vlorë, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore”.

Gjatë inspektimit të strukturave përkatëse janë bërë vlerësimet për kryerjen e detyrave në lidhje me:

- *evidentimin e dokumentimin e kallëzimeve të qytetarëve;*
- *evidentimin e hartimit të strategjisë së policimit në komunitet;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave lidhur me dosjet e kërkimit në sektorët e DPQ-ve dhe komisariate;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave lidhur me dosjet e personave me precedent kriminal;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave lidhur me dosjet e proçedimit policor në sektorët e drejtorive;*
- *dosjet hetimore të pezulluara në sektorë dhe komisariate;*
- *evidentimin e nivelit të zbulueshmërisë së veprës penale të “vjedhjes” në komisariate;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave lidhur me informacionin policor, në sektorët kundër krimeve të rënda, narkotikëve, trafikëve dhe krimit ekonomik;*
- *evidentimin e dokumentimin e statistikave në lidhje me veprat penale të referuara nga sektorët e luftës kundër krimit ekonomik, krimeve të rënda, narkotikëve dhe trafikëve;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave lidhur me informacionin policor në strukturat e rendit dhe sigurisë publike në komisariate;*
- *evidentimin e përdorimit të sistemeve elektronike në shfrytëzim nga strukturat policore;*
- *evidentimin e menaxhimit të burimeve njerëzore (emërimet, transferimet, ngritja në detyrë, largimet e përjashtimet);*
- *evidentimin e përdorimit të automjeteve të shërbimit brenda dhe jashtë orarit zyrtar;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave lidhur me shërbimin e transportit;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave të certifikimit të SHRSF-ve;*
- *menaxhimin e shërbimeve të policisë rrugore;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave në sektorin e buxhetit financës lidhur me gjokat e policisë rrugore;*
- *evidentimin e zbatimit të procedurave të Organit Administrativ Shtetëror;*
- *evidentimin e menaxhimit të ndërtesave, buxhetit, financave e prokurorimeve;*
- *evidentimin e zbatimit të rekomandimeve në inspektimet e mëparshme;*

REKOMANDIMET E DHËNA

- Nga specialistët e hetimit të krimit në sektorët e DPQ-ve Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë si dhe në Komisariate, të zbatohen me rigorozitet kërkesat e akteve nënligjore për administrimin, trajtimin, verifikimin e burimeve të informacionit dhe vlerësimin e dhënave.
- Nga strukturat e DPQ-ve në bashkëpunim me DPPSH-në të hartohet dhe miratohet një akt mbi bazën e të cilit të përcaktohet lloji i dokumentacionit ose protokoll pune që duhet të administrojë një specialist i hetimit të krimit në sektorët e DPQ-ve;

- Nga ana e DPQ-së Tiranë dhe DPPSH-së të hartohet dhe miratohet një procedurë administrative, lidhur me dokumentimin e procedurave të kallzimeve të qytetarëve, në ato raste kur nuk konstatohen elementë të figurës së veprës penale, në formë të shkruar dhe elektronike, në kuadër të rritjes së transparencës dhe rritjes së besimit të komunitetit;
- Nga Komisaritet e DPQ-së Tiranë të rritet në mënyrë të ndjeshme dhe të shpejtë puna zbuluese dhe dokumentuese për grupin e veprave penale kundër pronës dhe konkretisht të vjedhjes, goditjen e elementëve kriminal, që merren me këtë veprimtari dhe vënien e autorëve para drejtësisë;
- Nga ana e strukturave të rendit në komisariate dhe seksioni i analizës së Informacionit Kriminal, në DPQ-në Korçë, të merren masa për përmirësimin e punës me informacionin policor të siguruar nga strukturat e rendit (Patrulla të Përgjithshme dhe SPZ-të), duke e fokusuar punën tek cilësia e jo tek sasia;
- Nga specialistët e hetimit të krimit në DPQ-në Vlorë e Komisariate, të zbatohen me rigorozitet kërkesat e akteve nënligjore për administrimin, trajtimin, verifikimin e burimeve të informacionit dhe vlerësimin e dhënave;
- Nga strukturat përkatëse të DPQ-së Vlorë, të merren masat për pajisjen me çertifikatë sigurie për njohjen e informacionit të klasifikuar të personelit, i cili ka të drejtën e njohjes së informacionit të klasifikuar;
- Nga strukturat drejtuese të DPQ-së Vlorë në bashkëpunim me DPPSH-së të merren masat për ndërtimin dhe standardizimin e dhomave të sigurisë e të shoqërimit;
- Të merren masa për përmirësimin e kushteve të dhomave të shoqërimit dhe sigurisë në Komisariatin e Policisë Vlorë, Sarandë dhe Delvinë, në përputhje me standardet e miratuara.
- Të trajnohen dhe njihen punonjësit e strukturave të Rendit dhe Sigurisë Publike në lidhje me procedurat standarde të punës dhe aktet ligjore të cilat normojnë punën e tyre;
- Në Komisariatin e Policisë, Vlorë të vihet në funksionim sistemi “ADAM”;
- Nga strukturat përkatëse të DPQ-ve Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Vlorë, të zbatohen me rigorozitet procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore (rekrutim, transferim, lëvizje, emërim, lirim, përjashtim), në mbështetje të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 për “Policinë e Shtetit”, “Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit”, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e procedurave standarde të Punës për shërbimet mbështetëse”;
- Për ripranimet që bëhen në DPPSH, t’u jepet përparësi punonjësve të policisë që trajtohen me pagesë kalimtare, siç parashikohet në nenin 90 të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 për “Policinë e Shtetit”;
- Nga strukturat përkatëse të D.P.Q-së Tiranë të rakordohen me përgjegjshmëri në të gjitha nivelet në përputhshmërinë e statistikave që paraqiten në analiza, në regjistrat e regjistrimit të ngjarjeve dhe shkresave dhe materialeve referuese në Prokurori;
- Nga Komisaritet Rajonale të Policisë Rrugore Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Vlorë, të zbatohen me përpikmëri kërkesat e akteve nënligjore dhe rregulloreve që normojnë mënyrat e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore, si dhe aktit administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Shtetit, në lidhje me realizimin e proceseve të punës nga strukturat e policisë rrugore në nivel qendror dhe vendor.
- Nga Komisaritet Rajonale të Policisë Rrugore Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Vlorë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të DPPSH-së, të merren masa për trajnimin e punonjësve të policisë rrugore, lidhur me plotësimin dhe administrimin e dokumentacionit përkatës;

- Nga Seksioni i Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative në vendimet e marra, të saktësohet drejtë baza ligjore e trajtimit të shkeljeve të Kodit Rrugor. Të vendoset pjesa sanksionuese dhe ndëshkuese e dispozitës;
 - Në shërbimin e transportit, lëvizja e mjeteve dhe rregjistrimi i lëvizjes së tyre të bëhet në bazë e për zbatim të aktit administrativ të Ministrit të Brendshëm, i cili përcakton rregullat për menaxhimin e mjeteve në Policinë e Shtetit;
 - Nga strukturat përkatëse të DPQ-ve Elbasan, Korçë e Vlorë (sektori ekonomik), të normohet puna për furnizimin e mjeteve të policisë siç parashikohet në Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 - Në DPQ-në Korçë (Sektori Ekonomik) për shpenzimet e kryera shërbime transporti të respektoj plotësisht kërkesat e ligjit Nr 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (në defektet e mjeteve të ngarkoj me përgjegji personat përgjegjës për dëmtimin e mjeteve) dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që normojnë prokurimet;
 - Sektori i Financës në zbatim të aktit administrativ që normon rregullat dhe procedurat që ndiqen për gjobat që vendosen nga Komisariati i Policisë Rrugore, të disiplinojë mënyrën e dorëzimit të fletëve të bardha të gjobave, arkëtimin dhe maturimin e tyre;
 - Të monitorohet në mënyrë periodike procesi i regjistrimit të gjobave, rakordimi i tyre mes sasisë së gjobave të vendosura dhe sasinë e atyre të hedhura në sistem. Rakordimi të bëhet me Seksionin e Verifikimit, Edukimit dhe Statistikës për gjobat e vëna;
 - Sektori ekonomik të marrë masa për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm sipas kërkesave të ligjit nr. 10 926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit”, për menaxhimin e ndërtesave, buxhetit, financave e prokurorimeve;
 - Të merren masa të menjëhershme për shtimin e organikës së Seksionit të Patrullës së Përgjithshme me specialist për SHRSF-të, për të garantuar kontroll të vazhdueshëm dhe efektiv për SHRSF-të në DPQ-në Elbasan;
 - Nga ana e DPQ-ve Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe DPPSH-së, të merren masa urgjente dhe të trajtohen me përgjegjshmëri rekomandimet e lëna nga Drejtoria e Inspektimit.
 - Të merren masa administrative dhe të fillojë ecuria disiplinore për personat përgjegjës;
6. **“Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Durrës”.**
7. **“Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Korçë”.**

Qëllimi i inspektimit: “Të evidentojë, analizojë dhe vlerësojë me objektivitet, performancën e Drejtorive Rajonale të Kufirit e Migracionit Durrës dhe Korçë, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore”.

Gjatë inspektimit të strukturave përkatëse janë bërë vlerësimet për kryerjen e detyrave në lidhje me:

- *Evidentimi i zbatimit të procedurave lidhur me zbulueshmërinë e krimeve ndërkuftare, ku u konstatua se:*
 - o mungon bashkëpunimi/koordinimi midis DPQ-së dhe DRKM-së Korçë në rastin e konstatimit dhe evidentimit të një vepre penale jo objekt i punës së DRKM-së Korçë;
 - o pasqyrim i dyfishtë i statistikave nga DPQ-ja dhe DRKM-ja për veprat penale të evidentuara, rritje fiktiviteti;
 - o numër mjaft i ulët i veprave penale të evidentuara nga kjo drejtori, duke marrë parasysh shtrirjen territoriale, pozitën gjeografike dhe analizën e riskut për krimet ndërkuftare që ndodhin në këtë territor.

- *Verifikimi i punës operative-procedurale të hetimit dhe analizës së riskut, ku u konstatua se:*
 - o numër mjaft i ulët i informacioneve policore, për një periudhë kohore 12 mujore, duke patur parasysh që numri i punonjësve që kanë si detyrë funksionale marrjen e informacionit policor është 255 punonjës;
 - o analiza e riskut ndërtohet mbi bazën e informacionit policor, çdo javë nga strukturat përkatëse;
 - o numër i ulët informacionesh policore, analizë risku subjektive;
 - o nuk ishte evidentuar asnjë person me precedent kriminal, konstatim mjaft i dobët i punës operative;

- *Zbatimi i procedurave të kontrollit të kufirit të gjelbër dhe atij blu, ku u konstatua se:*
 - o kontrolli i kufirit blu (liqeni i Ohrit), kryhej nëpërmjet një mjeti lundrues (skaf);
 - o sasi e pamjaftueshme karburanti për vënien në lëvizje të mjetit lundrues;
 - o qëndrimi në pjesën më të madhe të kohës, i mjetit lundrues i stacionuar;
 - o hapësira të gjata kohe, të pambuluara nga kontrolli i kufirit blu;
 - o mosbulim nga radari i të gjithë zonës së kufirit të gjelbër e blu, kryesisht të atyre zonave me risqe të mëdha të ushtrimit të kontrabandës;
 - o numri i punonjësve në dispozicion për të ushtruar kontrollin dhe monitorimin e kufirit të gjelbër, nuk i përgjigjet vijës kufitare dhe nivelit të krimit ndërkufitar.

- *Evidentimi i zbatimit të procedurave të akt - prapësimeve dhe akt - refuzimeve në Kufi, ku u konstatua se:*
 - o mungonte akti nënligjor për miratimin dhe përdorimin e modelit të “Akt Refuzimit në Kufi”;
 - o numër i madh praktikash refuzimi, të cilat nuk parashikohen në kërkesat e nenit 25 të ligjit nr. 9861 “Për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit”;
 - o mungonte akti nënligjor për miratimin dhe përdorimin e modelit të “Akt prapësimit (refuzim) të shtetasve të huaj në kufi”;
 - o ligji për të huaj, nuk e përkufizon termin “prapësim” si dhe nuk parashikon të gjitha rastet e mundshme të prapësimit, rrjedhimisht bën aktet absolutisht të pavlefshme;
 - o nuk rakordonin praktikat e akt refuzimeve me sistemin TIMS dhe komunikatat ditore;
 - o nuk kishte një procedurë të përcaktuar për administrimin e praktikave të akteve të refuzimit.

- *Evidentimi i zbatimit të procedurave lidhur me shërbimin e transportit, ku u konstatua se:*
 - o lëvizja e mjeteve, pa regjim dispeceri, në mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në aktin administrativ të Ministrisë të Brendshme, që normon rregullat dhe procedurat që ndiqen për menaxhimin e Mjeteve në Policinë e Shtetit”;
 - o për mjetet me targa Policie, nuk janë kryer të gjitha procedurat dhe detyrimet e përcaktuara në “Kodin Rrugore”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

- *Evidentimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, ku u konstatua se:*
 - o ka problematika në administrimin e dosjeve të personelit, në mospërputhje me Procedurat Standarde të Policisë së Shtetit dhe Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 për “Policinë e Shtetit” dhe “Rregulloren e Personelit”.

REKOMANDIMET E DHËNA

- Nga DRKM Korçë të hartohen prioritete dhe objektiva të matshëm dhe të arritshëm;
 - Nga DRKM të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi me DPQ-në, Korçë lidhur me pasqyrimin e statistikave të evidentimit të veprave penale, në mënyrë që të mos ketë pasqyrim të dyfishtë, të evidentimit dhe zbulueshmërisë së veprave penale dhe rrjedhimisht fiktivitet;
 - Nga DRKM Korçë të merren masa konkrete për rritjen e numrit dhe cilësisë së informacionit policor, si baza e punës së strukturave të Policisë së Shtetit;
 - Nga DRKM Korçë të merren masa konkrete dhe imediate, në evidentimin e personave me precedent kriminal sipas tendencave të krimeve ndërkufitare, ngritjen e punës në proçedime policore dhe vënien e autorëve para drejtësisë;
 - Nga DRKM Korçë analizat e riskut të hartohen mbi informacione policore të administruara, përpunuara dhe analizuara, jo mbi baza hipotetike, në drejtim të rritjes së evidentimit të veprave penale ndërkufitare;
 - Nga DRKM, Korçë në bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në DPPSH të merren masa konkrete për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve logjistike për të garantuar kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit në mënyrë të plotë dhe efçente;
 - Nga DRKM, Korçë në bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në DPPSH të merren masa imediate për mbulimin me radar të të gjithë kufirit të gjelbër dhe blu, për të eliminuar kështu riskun e ushtrimit të kontrabandës dhe trafikëve të paligjshme në zonat e pakontrolluara nga policia;
 - Nga DRKM, Korçë dhe Durrës të zbatohen me korrektësi kërkesat e nenit 25 të ligjit nr. 9861 “Për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit”, lidhur me arsyet e refuzimit të shtetasve në kufi.
 - Nga DRKM, Korçë dhe Durrës, të zbatohen me korrektësi kërkesat e nenit 9 të Ligjit nr.9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt”, lidhur me arsyet e prapësimit të shtetasve të huaj ne kufi.
 - Nga DRKM Korçë dhe Durrës në bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në DPPSH, të hartohet dhe miratohet një format standard për aktet e refuzimit të shtetasve në PKKK, si dhe të përcaktohen proçedurat e administrimit të praktikave të akteve të refuzimit.
 - Në shërbimin e transportit (shërbimi i financës) lëvizja e mjeteve të bëhet me regjim dispeçeri, dhe të evidentohen në dokumentat përkatës siç parashikohet në Urdhërin e Ministrit të Brendshëm Nr.29, datë 05.02.2010 “Për Rregulloren e Mjeteve në Policinë e Shtetit”.
 - Në DRKM Korçë (shërbimi i financës) të normohet administrimi i “kuponit tatimor” për furnizimet e mjeteve që bëhen me karburant siç parashikohet në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 - Në rastet e transferimeve, nga ana e Sektorit të Administratës së DRKM-së Korçë, të administrohet dokumentacioni sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 për “Policinë e Shtetit”, Manualit për Proçedurat Standarde në Policinë e Shtetit” dhe “Rregulloren e Personelit”;
 - Nga DRKM-të Korçë dhe Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të merren masat e menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë inspektim dhe atë të mëparshëm.
8. **“Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Komisarariatit të Menaxhimit të Trafikut Interurban Lezhë”.**
9. **“Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Komisarariatit të Menaxhimit të Trafikut Interurban Lushnjë”.**

10. “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Komisarariatit të Menaxhimit të Trafikut Interurban, Elbasan”.

Qëllimi i inspektimit: “Të evidentojë, analizojë dhe vlerësojë me objektivitet, performancën e Komisariateve të Menaxhimit të Trafikut Interurban, Lushnjë, Lezhë, Elbasan në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore”.

KONKLUZIONE

- Komisarariatet e Menaxhimit të Trafikut Interurban Lushnjë, Lezhë, Elbasan, për vitin 2013 nuk kishin hartuar dhe miratuar një plan veprimi me objektiva dhe prioritete të matshëm dhe të arritshëm, në mënyrë që të matej performanca e këtyre strukturave policore;
- Nuk zbatoheshin me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor dhe aktit administrativ të Ministrit të Brendshëm, që normon rregullat për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative;
- U konstatuan probleme në procesverbalet e konstatimit të shkeljes, nga ana e përpilimit dhe përmbajtjes së tyre, duke mos u aplikuar pjesa konstatuese dhe ndëshkuese e dispozitës së shkelur, duke sjellë pavlefshmëri absolute të proces-verbalit si titull ekzekutiv.

REKOMANDIMET E DHËNA

- Në zbatim të strategjisë 5-vjecare të Policisë së Shtetit, strukturat e Komisariateve të Menaxhimit të Trafikut Interurban Lezhë, Lushnjë, Elbasan të hartojnë dhe miratojnë plane-veprimi me objektiva dhe prioritete të matshëm dhe të arritshëm, në mënyrë që të matet performanca e këtyre strukturave policore.
- Nga strukturat e KMTI, Lezhë, Lushnjë, Elbasan të zbatohen me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor dhe aktit administrativ të Ministrit të Brendshëm, që normon rregullat për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative;
- Nga strukturat e KMTI, Lezhë, Lushnjë, Elbasan, të mbahet dhe administrohet dokumentacioni sipas aktit administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili normon rregullat dhe procedurat për realizimin e proceseve të punës strukturat e policisë rrugore në nivel qendror dhe vendor.
- Nga strukturat e KMTI, Lezhë, Lushnjë, Elbasan, të merren masa për planifikimin e trajnime të personelit të tyre, lidhur me mënyrën e plotësimit të proces-verbalit të konstatimit të shkeljes, pasi rezultojnë mangësi të theksuara në këtë drejtim;
- Të parashikohen trajnimet e nevojshme për punonjësit kryesisht në funksionet “trup shërbimi”, lidhur me njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë punën e Policisë së Shtetit.

11. “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Seksionit të Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative, Tiranë”.

12. “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Seksionit të Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative Durrës”.

13. “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Seksionit të Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative Lezhë”.

14. “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Seksionit të Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative Fier”

Qëllimi i inspektimit: “Garantimi i një veprimtarie të përgjegjshme, demokratike dhe transparente të strukturave të Seksionit të Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative, Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Fier, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standartet e kërkuara”.

KONKLUZIONE

- Nuk zbatoheshin me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor dhe aktit administrativ të Ministrit të Brendshëm, që normon rregullat për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor, e konkretisht:
 - o u konstatuan raste ku në procesverbalet e konstatimit të shkeljes nuk shkruhet referenca ligjore që parashikon masën ndëshkuese dhe atë plotësuese;
 - o u konstatua se komisioni për të gjitha rastet e sipërmëndura nuk i ka revokuar procesverbalet e konstatimit të shkeljes por i ka ligjëruar ato;
 - o u konstatuan raste të mosrespektimit të neneve të Kodit Rrugor gjatë vendosjes së masave ndëshkuese dhe plotësuese;
 - o u konstatua se në asnjë nga rastet e sipërpërmendura nga OASH, nuk ishin revokuar këto procesverbale;
 - o u konstatuan problematika në përpilimin jo të saktë dhe të plotë të praktikave nga agjentët verifikues për trajtimin në komision;
 - o u konstatua se nuk është marrë asnjë masë administrative ndaj shkeljeve të punonjësve të qarkullimit, për mënyrën e plotësimit të procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve, e cila konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore;

REKOMANDIMET E DHËNA

- Nga Seksioni i Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative, të zbatohen me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor dhe aktit administrativ të Ministrit të Brendshëm, që normon rregullat për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor, në lidhje me problematikën e konstatuara;
- Të merren masa urgjente për mënyrën e administrimit të dokumentacionit, me përgjegjësi konkrete sipas aktit administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili normon rregullat dhe procedurat për realizimin e proceseve të punës strukturat e policisë rrugore në nivel qendror dhe vendor.
- Nga Seksioni i Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative të raportohen të gjitha rastet e mangësive në plotësimin e proces-verbaleve të konstatimit të shkeljeve nga agjentët verifikues, për fillimin e ecurisë disiplinore, në përputhje me pikën 8, të aktit administrativ të Ministrit të Brendshëm, që normon rregullat për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor
- Nga Seksioni i Shqyrtimit të Kundravajtjeve Administrative në bashkëpunim me Komisaratin e Trafikut Rrugor, Tiranë të merren masa urgjente për mënyrën e plotësimit të proces-verbalit të shkeljes si titull ekzekutiv dhe si baza e veprimtarisë së shërbimeve të Policisë Rrugore.

INSPEKTIVE JASHTË RADHE

1. “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Shkodër”

Qëllimi i inspektimit: “Të evidentojë, analizojë dhe vlerësojë me objektivitet, performancën e Drejtorisë Rajonale të Kufirit e Migracionit Shkodër në ushtrimin e veprimtarisë së saj, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore”.

Gjatë inspektimit të strukturave përkatëse janë bërë vlerësimet për kryerjen e detyrave në lidhje me:

- *Evidentimi i zbatimit të procedurave lidhur me zbulueshmërinë e krimeve ndërkufitare*, ku u konstatuan se:
 - o pasqyrimi në statistikën e strukturave të drejtorisë të rasteve për vepra penale jo objekt i punës së kufirit dhe migracionit;
 - o mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi në rastet e konstatimit dhe evidentimit të një vepre penale jo objekt i punës së DRKM-së me strukturat e DPQ-së Shkodër;
 - o numër relativisht i ulët i veprave penale të evidentuara nga DRKM Shkodër, duke marrë parasysh, shtrirjen territoriale, pozitën gjeografike (natyrën e vijës kufitare) dhe analizën e riskut për krimet ndërkufitare që ndodhin në këtë territor.
- *Evidentimi i punës operative-procedurale të hetimit dhe analizës së riskut*, ku u konstatuan se:
 - o numër mjaft i ulët i informacioneve policore, duke patur parasysh që numri i punonjësve që kanë si pjesë të detyrave funksionale marrjen e informacionit policor është 151 punonjës;
 - o analiza e riskut ndërtohet mbi bazën e informacionit policor, çdo javë nga strukturat përkatëse;
 - o numër i ulët informacionesh policore, analizë risku subjektive;
 - o nuk ishte evidentuar asnjë person me precedent kriminal, konstatim mjaft i dobët i punës operative;
- *Zbatimi i procedurave të kontrollit të kufirit të gjelbër dhe atij blu, ku u konstatua se:*
 - o kontrolli i kufirit blu (liqeni i Shkodrës), kryhej nëpërmjet një mjeti lundrues (skaf);
 - o sasi të limituara karburanti për vënien në lëvizje të mjetit lundrues;
 - o qëndrimi në pjesën më të madhe të kohës, i mjetit lundrues i stacionuar;
 - o hapësira të gjata kohe, të pambuluara nga kontrolli i kufirit blu;
 - o mosmbulim nga radari i të gjithë zonës së kufirit të gjelbër e blu, kryesisht të atyre zonave me risqe të mëdha të ushtrimit të kontrabandës;
 - o numri i punonjësve në dispozicion për të ushtruar kontrollin dhe monitorimin e kufirit të gjelbër, nuk i përgjigjet vijës kufitare dhe nivelit të krimit ndërkufitar.
- *Zbatimi i rekomandimeve të mëparshme, ku u konstatua se:*
 - o një numër relativisht i madh rekomandimesh të parrealizuara ose të realizuara pjesërisht nga strukturat policore përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në inspektimet e mëparshme.

REKOMANDIMET E DHËNA

- Nga DRKM, Shkodër të hartohen prioritete dhe objektiva të matshëm dhe të arritshëm;

- Nga DRKM, Shkodër të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi me strukturat e DPQ-së Shkodër, lidhur me pasqyrimin e statistikave të evidentimit të veprave penale, për të mos patur pasqyrim të dyfishtë të evidentimit dhe zbulueshmërisë së veprave penale dhe rrjedhimisht fiktivitet;
- Nga DRKM, Shkodër të merren masa imediate për rritjen e numrit dhe cilësisë së informacionit policor, si baza e punës së strukturave të Policisë së Shtetit;
- Nga DRKM, Shkodër të merren masa imediate në evidentimin e personave me precedent kriminal sipas tendencave të krimeve ndërkufitare, ngritjen e punës në procedime policore dhe vënien e autorëve para drejtësisë;
- Nga DRKM, Shkodër analizat e riskut të hartohen mbi informacione policore të administruara, përpunuara dhe analizuara, jo mbi baza hipotetike, në drejtim të rritjes së evidentimit të veprave penale ndërkufitare;
- Nga DRKM, Shkodër në bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në DPPSH, të shihet mundësia e rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe mjeteve logjistike për të garantuar kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit në mënyrë të plotë dhe efçente;
- Nga DRKM, Shkodër në bashkëpunim me DPPSH-në, të merren masat e menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

2. “Inspektimi i dosjeve të personelit të punonjsve të Policisë së Shtetit për gradat Zv/Drejtor i Përgjithshëm, Drejtues i Parë, Drejtues në DPPSH, DPQ Lezhë e Komisariati Special, RESI”

Nga Inspektimi i dosjeve për 171 funksionarë të Policisë së Shtetit, respektivisht; **5 Zv/Drejtor të Përgjithshëm, 44 Drejtues të Parë, dhe 122 Drejtues**, rezultoi që ngritja në gradë dhe në karriere për këta punonjës, është bërë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

Nga verifikimi i dosjeve të 29 punonjësve të DPQ-së, Lezhë rezultoi se për 5 punonjës policie të rolit baza ecuria në gradë dhe karrierë është bërë në kundërshtim me ligjin, si dhe të gjitha këto dosje paraqisnin problematika në administrimin e dokumentacionit.

Nga verifikimet e dosjeve të personelit për 44 punonjës të Seksionit të Njësisë Operacionale në Komisaratin Special Resi rezultoi se punonjësit e kësaj njësie, duke mos u zbatuar kriteret e pranimit dhe qëndrimit në punë, duke mos u zhvilluar procedurat e konkurimit, duke mos u zhvilluar testimet vjetore dhe pa programe stërvitje fizike, janë në kundërshtim me aktet ligjore dhe nën ligjore që normojnë funksionimin e kësaj strukture speciale operacionale.

3. “Inspektimi i procedurave të ndjekura nga Seksionet Kundër Krimit Ekonomik në të gjithë DPQ-të, në kuadër të operacionit “Fund Marrësisë”

Mbi bazën e konstatime të evidentuara në raportin e inspektimit u sugjerua strukturave kompetente të Policisë së Shtetit, fillimi i ecurisë disiplinore për 42 punonjës, nga të cilat 17 prej tyre janë trajtuar si **“shkelje e rëndë”** e disiplinës dhe 15 prej tyre si **“shkelje e lehtë”** e disiplinës. Ndërsa për 7 punonjës është sugjeruar **“këshillim”**, si masë jo disiplinore.

Gjithashtu strukturat përkatëse të hetimit të SHKB-së, e përdoren si indicje materialin e inspektimit si dhe atë të përfutur nga burime të tjera informacioni për të kallëzuar në prokurori 2 raste të kryerjes së veprës penale **“të veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”** dhe **“shpërdorimit të detyrës”** para dhe gjatë kryerjes së këtij operacioni policor, nga 4 punonjës policie në bashkëpunim dhe me

shtetas, pronar lojrash fati. Çështjet penale të rregjistruara në prokurorite përkatëse i janë kaluar për delegim kompetencash sektorevë të SHKB-së, dhe janë në hetim.

4. “Inspektimi i zbatimit të procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Policisë Fier, lidhur me administrimin e pronave”

Nga inspektimi rezultoi se: objektet ndërtimore pronë e DPQ-së Fier ishin pushtuar dhe zaptuar nga pronarët, duke konsumuar veprat penale të “Pushtimit të Tokës”, “Shkatërrimit të pronës” dhe të “Vetgjqësise”, parashikuar nga nenet 200, 150 dhe 277 të Kodit Penal. Nga strukturat e DPQ-së Fier, nuk është bërë asnjë referim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, për personat që kanë konsumuar elementët e veprave penale të sipërpërmendura.

Lidhur me këto konstatime, Drejtoria e Inspektimit ka sugjeruar fillimin e procedimit penal për 2 punonjës policie, për veprën penale të “Shpërdorimit të Detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit penal, si dhe fillimin e ecurisë disiplinore, në ato raste kur nuk ka elementë të figurës së veprës penale.

5. “Inspektimi i zbatimit të procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për prokurimet e spoteve publicitare”

Konstatimet dhe gjetjet e raportit të inspektimit janë përdorur nga strukturat e hetimit të SHKB-së si indicje për referimin e veprës penale të kryer “shpërdorim detyre” dhe “shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike” në bashkëpunim parashikuar nga nenet 25, 248 e 258 të KP, në ngarkim të 8 punonjësve civilë të policisë dhe 2 drejtues të lartë të strukturave të policisë, pranë njësisë së përbashkët hetimore kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prokuroria ka rregjistruar procedimin penal dhe çështja është në hetim.

6. “Për zbatimin e procedurave lidhur me informacionet e dërguara nga Shërbimi Informativ Shtetëror, në DPPSH”

Nga konstatimet dhe gjetjet e raportit të inspektimit rezulton se:

- procedurat që ndiqeshin në lidhje me informacionet e dërguara nga SHISH, realizoheshin në zbatim të udhëzimit nr. 1474, datë 27.09.2007;
- Rekomandohet rritja e kontrollit të brendshëm nga drejtuesit e strukturës qendrore ndaj strukturave vendore lidhur me veprimet e kryera nga specialistët për ndjekjen e informacioneve;

7. “Inspektim në Qendrën e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit të Ministrit”

Nga inspektimi rezultoi se që gjatë evakuimit të materialeve nga Objekti “Linzë”, nuk janë ndjekur procedurat e magazinimit dhe inventarizimit të këtyre materialeve në QSHAMT. Madje gjatë kqyrjes fizike të këtyre materialeve në magazinë rezultoi se nuk gjendeshin aty duke sjellë dyshime të bazuara për konsumimin e veprës penale të “Vjedhjes e kryer duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal.

Materialet e administruara i kaluan Drejtorisë së Policisë Qarkut Tiranë, Sektorit Kundër Krimit Ekonomik dhe sugjeruar për referimin në prokurori për veprën penale “të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, për 3 punonjës të këtyre strukturave.

8. “Vlerësimi i procedurave të zhvillimit të kursit 11 javor, për patrullat e përgjithshme”

Nga inspektimi rezultoi se janë shkelur procedurat ligjore të testimit nga ana e komisioneve të testimit, duke rimarrë në kundërshtim me Ligjin për Policinë e Shtetit, Manualin për Zhvillimin e kurseve të shkollimit bazë në Qendrën e Formimit Policor, 9 kursantë të testuar më parë e të vlerësuar negativisht për kursin 11 javor, patrullë e përgjithshme, të shkollimit bazë, gjatë periudhës Janar – Shtator 2013.

Konstatimet/gjetjet e raportit të inspektimit, shërbyen si indicje për kallëzimin në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale të “Shpërdorimit të Detyrës”, të **3** punonjësve të policisë të nivelit të mesëm dhe të parë drejtues. Prokuroria ka rregjistruar procedimin penal të vitit 2013 dhe çështja është ende në hetim.

9. Ankesat e Publikut

Në vlerësimin tonë ka qenë e gabuar vendosja e strukturës së marrjes dhe përpunimit të ankesave të publikut në strukturën e shërbimeve mbështetëse dhe do të propozojmë atë si pjesë përbërëse të strukturës së drejtorisë së inspektimit duke i dhënë vendin kryesor dhe të ngrihet në nivel sektori. Hetimi administrativ i ankesave do të jetë pjesë përbërëse dhe prioritet i kësaj strukture.

Gjatë vitit 2013, janë administruar dhe trajtuar **255** ankesa të shtetasve, ardhur pranë strukturave të shërbimit nëpërmjet portave kryesore të komunikimit që shërbimi ka vënë në dispozicion të publikut; me postë zyrtare; plotësimin të formularit të ankesës në zyrën e informacionit dhe ankesave të shërbimit, linjës jeshile **0800 90 90** etj. Gjatë procesit të trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave të shtetasve, veçanërisht në periudhën e 4-mujorit të fundit të vitit, i është kushtuar rëndësi e veçantë marrjes së kontaktit të drejtpërdrejtë me qytetarin, duke i telefonuar, duke i mirëpritur në zyrat e shërbimit apo edhe në ambjentet e tyre private, si banesa apo edhe vende pune. Gjithashtu brenda afatit ligjore prej 30 ditësh të përcaktuar në rregulloret e shërbimit, i është kthyer përgjigje ankuesit mbi përfundimit e arritura pas procesit të verifikimit të ankesës/denoncimit të tij/të saj.

Nga totali i ankesave të shqyrtuar prej strukturave të hetimit të shërbimit në rreth **15%** të tyre, është konstatuar shkelje e procedurave nga punonjësit e policisë dhe është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore prej strukturave përkatëse të Policisë së Shtetit, ndaj personave përgjegjës.

Ndërsa Drejtorisë së Inspektimit, i janë deleguar për të shqyrtuar dhe verifikuar **12** ankesa të dërguara nga qytetaret, shifër kjo mjaft e ulët. Në përfundim të të cilave rezultoi se: në **6** prej tyre ka patur shkelje të procedurave nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore për personat përgjegjës, në **4** raste për pretendimet nuk u konstatua shkelje e procedurave dhe në **2** raste materialet i janë dërguar Drejtorisë së Hetimit për ndjekje penale. Për këto **2** raste nga strukturat e hetimit të shërbimit është bërë kallëzimi në prokurori dhe ka filluar procedimi penal për **5** punonjës policie.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE SEKTORI I FINANCËS

Si struktura mbështetëse të shërbimit, kjo drejtori dhe sektori i financës, kanë kryer detyrat gjatë vitit 2013, për administrimin dhe mirëmenaxhimin e burimeve financiare, mjeteve dhe pajisjeve që përdoren nga personeli i shërbimit si dhe atë të burimeve njerëzore.

Sektori i financës

Nr.	Art.	E m ë r t i m i	BUXHETI I VITIT 2013		Diferenca plan-fakt	Realizimi ne %
			Plani vjetor	Realizimi		
1	600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	90,973,000	88,800,973	2,172,027	98
2	601	Kontribute për Sig.Shoqërore dhe Shëndetësore	14,590,000	14,531,526	58,474	100
3	602	Mallra dhe shërbime të tjera	20,000,000	14,917,320	5,082,680	75
4	606	Transferime per buxhetet familjare dhe individet	4,430,000	1,500,443	2,929,557	34
5	231	Shpenzime për investime	7,000,000	5,172,473	1,827,527	74
TOTALI			136,993,000	124,922,735	12,070,265	91

Njësia e Personelit

Gjatë kësaj periudhe është vënë theksi në forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, për parandalimin, zbulimin dhe dokumentimin ligjor të shkeljeve administrative dhe ligjore brenda rradhëve të shërbimit. Kjo është arritur nëpërmjet rishikimit të procedurave të ndjekura gjatë procesit të rekrutimit, emërimit, ecurisë në karrierë e gradë të punonjësve të personelit hetues e inspektues të shërbimit.

Gjithashtu ecuria disiplinore është inicuar edhe në ato raste kur janë evidentuar shkelje ose mospërbushje të detyrës funksionale si nga punonjës të personelit hetues, inspektues dhe të shërbimeve mbështetëse. Janë dhënë masa disiplinore deri në “përgjashtim nga SHKB-ja”, mbi bazën e një procesi transparent dhe të drejtë disiplinor. Konkretisht masat e dhëna janë:

Për Personeli Hetues

- në 6 raste është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**
- në 1 raste është dhënë masa disiplinore **“Ulje në gradë”**
- në 2 raste është dhënë masa disiplinore **“gjobë sa e paga e punonjësit për 5 ditë pune”**
- në 6 raste është dhënë masa **“Përgjashtim nga SHKB-ja”**

Për Personeli Inspektues dhe Mbështetes

- në 3 raste është dhënë masa **“Vërejtje”**
- në 1 rast është dhënë masa **“Largim nga Puna”**

TRAJNIMI I PERSONELIT HETUES DHE INSPEKTUES TË SHKB-së

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, ndër vite është asistuar nga ekspertët e programeve dhe misioneve që janë vendosur në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Shtetit e operojnë në zhvillimin e rritjen e kapaciteteve të brendshme të agjencive ligjzbatuese në vendin tonë, bazuar në praktikat më të mira policore, në respektimin e të drejtave dhe lirive të individit, shtetit të së drejtës dhe luftës ndaj korrupsionit.

Gjatë vitit 2013, asistenca e ofruar nga këto programe dhe misione, në veçanti ICITAP, OPDAT e OSCE, është konkretizuar në disa trajnime për personelin hetues dhe inspektues të shërbimit, pjesmarrjen në konferenca rajonale dhe ëorkshope në fushën e llogaridhënies policore, integritetit policor, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, konkretisht:

1. Trajnimi i **22** punonjësve të personelit hetues, në “Kursin e avancuar të hetimit” gjatë periudhës **14 – 25 Janar 2013 dhe 4 – 15 Shkurt 2013**, organizuar nga ICITAP, në drejtimin e 2 trajnuesve nga Britania e Madhe, në ambientet e Qendrës së Arsimit Policor.
2. Trajnimi i personelit të trupës operationale të SHKB-së, me temë “Veprimet e agjentëve nënmbulim” me 5 faza, organizuar nga OSBE, 3 prej të cilave në periudha, **21 – 25 Janar 2013, 25 Shkurt – 1 Mars 2013 dhe 25 – 29 Mars 2013**.
3. Seminari Rajonal “Për luftën kundër korrupsionit në polici, në zonën e Ballkanit Perendimor”, organizuar nga Ambasada Franceze në Shkup, Maqedoni, nga datat **18 – 20 Mars 2013**. Morën pjesë **2** punonjës të shërbimit.



Personeli i strukturave qendrore të SHKB-së, në MPB

4. Trajnimi i **10** drejtuesve të sektorëve të hetimit në qëndër e bazë në kursin “për teknikat e intervistimit”, nga data **06 – 10 Maj 2013**, organizuar nga prezenca e OSBE-se në Tiranë, nën drejtimin e 2 lektorëve britanikë, pranë Qendrës së Arsimit Policor.
5. Workshop “korrupsioni policor”, organizuar nga OPDAT, nga data **15 – 19 Korrik 2013**, në Hotel Rogner. Morën pjesë **10** punonjës të personelit hetues të SHKB-së, **10** prokurorë të Njësive të Përbashkëta Hetimor dhe lektor një Prokuror nga SHBA-ja. Shkëmbimi i eksperiencave në luftën kundër korrupsionit policor.
6. Seminarin teknik me temë “*Përdorimi i teknikave të avancuara të informacionit: Perspektiva e Agjencive Anti-Korrupsion*”, nga data **28 – 29 Tetor 2013**, në Lubjanë të Sllovenisë, organizuar nga EPAC dhe DPPB e BE. Mori pjesë **1** punonjës i sektorit të Analizës së SHKB-së.
7. Konferenca Rajonale e Njësive të Kontrollit të Brendshëm, me temë “Integriteti Policor dhe Mbikqyrja Policore”, zhvilluar në Shkup të Maqedonisë, nga data **5 – 7 Nëntor 2013**. Morën pjesën **2** punonjës të shërbimit. Organizuar nga OSCE dhe DCAF.

BASHKËPUNIMI ME DREJTORINË E STANDARDEVE PROFESIONALE

Ligji nr. **10002**, datë **06.10.2008** “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, neni 26 “hetimi i shkeljeve” si dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 114, datë 12.04.2010 “Për procedurat e mbledhjes së të dhënave dhe bashkërendimin e punës së SHKB-së me Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera të Ministrisë së Brendshme”, normojnë bashkëpunimin, bashkërendimin në fushën e shkëmbimit të ndërsjelltë të informacionit gjatë hetimit të shkeljeve.

Gjatë vitit 2013 është bashkëpunuar në **43** raste ku është konstatuar se punonjësit e policisë nuk kanë konsumuar elementë të veprës penale, por kanë kryer shkelje disiplinore.

Ndërsa Drejtoria e Standardeve Profesionale ka bërë kërkesë për **28** raste, ku nga ana jonë është dërguar një informacion i plotë mbi rezultatet e hetimeve penale të kryera ndaj punonjësve të policisë.

Nga **71** praktika disiplinore, të evidentuara më lartë, nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, janë dhënë këto rezultate për ecurinë disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje të ligjit dhe rregullave që normojnë punën e policisë:

- **11** raste ka përfunduar ecuria disiplinore
- **17** raste është dhënë masa disiplinore “Përfundim nga Policia e Shtetit”
- **2** raste është dhënë masa disiplinore “pezullim pa pagesë 10 ditë”
- **2** raste është dhënë masa disiplinore “pezullim pa pagesë 15 ditë”
- **9** raste është dhënë masa disiplinore “pezullim pa pagesë 30 ditë”
- **6** raste është dhënë masa disiplinore “pezullim pa pagesë 7 ditë”
- **4** raste është evidentuar shkelje e lehtë
- **5** raste është dhënë masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit 12 muaj”
- **5** raste është dhënë masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit 3 muaj”
- **4** raste është dhënë masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit 6 muaj”
- **1** rast është dhënë masa disiplinore “ulje në detyrë”
- **2** raste është dhënë masa disiplinore “ulje në gradë për 1 vit”
- **3** raste është dhënë masa disiplinore “largim nga puna”

OBJEKTIVA PËR SHKB-NË

1. Hartimi i ligjit të ri “Shërbimi për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme” në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
2. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri, riorganizimi strukturor dhe projektet që do të zbatohen gjatë fazës së implementimit.
3. Hartimi i planeve të veprimit për zbulueshmërinë e goditjen e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar ku implikohen punonjës policie me rezultate konkrete mujore dhe 3 – mujore.
4. Reformimi i Strukturës për marrjen e Ankesave të Publikut nga çdo komunë e rreth të vendit, nëpërmjet; Linjës së Gjellbërt **0800 90 90** pa pagesë, vendosjes së posterave, shpërndarjes së fletëpalosjeve, krijimit të faqes së internetit të SHKB-së, kutive postare, zyra të SHKB-së në komisariate etj.
5. Plane veprimi afatshkurtra dhe afatmese me masa dhe detyra konkrete, të zbatueshme dhe të matshme si nga ana sasiore ashtu dhe nga ajo cilësore, në kuadër të 5 prioriteteve të përcaktuara nga Bashkimi Europian për Shqipërinë në përgjithësi dhe në fushën e luftës kundër korrupsionit në veçanti.
6. Përmirësimi dhe rritja e performancës së shërbimit nëpërmjet rekrutimit në shërbim të ekspertëve të fushës dhe riorganizimit të strukturës operacionale.
7. Rritja e cilësisë së hetimit nëpërmjet përqasjes proaktive të investigimit, drejtimit dhe bashkëpunimit me Prokurorinë.
8. Reformim të strukturës së analizës së informacionit kriminal si nga ana organizative, strukturore e teknologjike, e ndërlidhur kjo edhe me sektorin e ankesave.
9. Rritja e ndikimit në fushën e llogaridhënies policore, integritetit policor, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, nëpërmjet analizave dhe vlerësimeve periodike të riskut.
10. Forcimin e bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend, në kuadër të zbatimit të objektivave strategjike të përcaktuara nga qeveria në fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.
11. Krijimi i një dimension të ri bashkëpunimi me OJQ, kryesisht ato që trajtojnë çështjet e policimit dhe problematikave që lidhen me të, me qëllim evidentimin në kohë të problemeve/problematikave në fushën e shërbimit policor dhe në veçanti të policimit në komunitet.

SI MUND TË NA KONTAKTONI

Adresa: Sheshi “Skënderbe”, Nr.3, Tiranë.

Tel/Fax: +355 4 22 71 735 & +355 4 22 53 516

Linjë telefonike pa pagesë për ankesat **0800 90 90**

Ëeb-site: www.shkb.gov.al, ku mund të merrni informacionin mbi veprimtarinë e SHKB-së si dhe mbi të gjitha mjetet që shërbimi i kanë vënë në shërbim të publikut për mënyrat e komunikimit.

E-mail: shkb@moi.gov.al, ku mund të dërgoni ankesa, informacione, etj, për shkelje të ligjit nga punonjës të Policisë së Shtetit.

Spektori i Inspektimit të Ankesave në godinën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku mund të depozitoni ankesën tuaj duke plotësuar formularin përkatës.

Drejtoria/Sektorët e SHKB-së në Qarqe

Mund të kontaktoni drejtpërdrejt punonjësit tanë të cilët gjenden pranë çdo strukture policore në nivel qarku, si në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë.

Ankesat ndaj punonjësve të policisë mund t'i bëni edhe pranë çdo strukture të Policisë së Shtetit.

Kutitë postare të SHKB-së pranë çdo Drejtori të Policisë në Qarqe dhe Komisariate.